REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
KESHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I EKONOMISE DHE ADMINISTRIMIT FINANCIAR

RAPORT VENDIMARRJE

Nr 21, Datë 23.12.2025

Lënda: Vendim për shqyrtimin e Projekt-Vendimit nr.....datë, .../...../2025 "*Per miratimin e PBA 2026-2028, Buxheti i vitit 2026, Bashkia Prrenjas*"

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Prrenjas

Hyrje

Ky projekt-vendim paraqitet nga *Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiar, dhe Sherbimit Social* dhe ka për qëllim:

BAZUESHMERIA LIGJORE DHE VOTIMI	*Mbeshtetur ne nenin 9, pika 1, 3, nenin 34 te ligjit nr 139/2015, "Per Vetqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ne nenin 34 te ligjit 68/2017 "Per Financat e Vetqeverisjes Vendore", i ndryshuar, ne ligjin nr 9936 date 26.06.2028, "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, ne ligin nr 10296, date 08.07.2010, "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, udhezimin nr 2 date 06.02.2012 "Per Proceduart Standarde te Pergatitjes se Programit Buxhetor Afat-mesem", ne udhezimin e Ministrise se Financave nr 8, date 28.02.2025 "Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afat-mesem vendor 2026-2028" me shtojcat perkatese si dhe VKB nr 126, date 26.12.2024 "Per miratimin e Kalendarit te Pergatitjes se Programit Buxhetor Afat-mesem 2026-2028.*
SITUATA AKTUALE E FUNKSIONIT	*Per hartimin e PBA 2026-2028 dhe Buxhetin e vitit 2026, Bashkia Prrenjas ka reflektuar mbi kerkesat dhe prioritetet e qytetareve. Persa i perket listes se prioriteteve per projekt buxhetin afatmesem 2026-2028 perparesi i eshte dhene infrastruktures rrugore, sherbimit social, mbrojtjes se mjedisit dhe sherbimeve per bujqesine.* *Bashkia ka konsideruar Strukturen e Programeve duke siguruar perfshirjen brenda nje programi shpenzimesh te funksioneve kryesore te njesise.* *Gjithashtu, eshte zhvilluar diskutimi GSM me drejtuesit e programeve per dokumentin e reziqeve te paraqitura prej tyre. Esht bere shperndarja tek cdo*

	ekip EMP i udhezimit te brendshem nga titullari ne lidhje me zbatimin e procedurave te programit buxhetor afatmesem. Jane nenshkruar te gjitha raportet e pergatitjes se kerkesave buxhetore per perdorim te brendshem te njesise ne lidhje me rishikimin e politikes se programit dhe planifikimit te shpenzimeve te programit. Eshte bere prezantimi i te gjitha dokumentave te kerkesave buxhetore prane Kryetarit te Bashkise.
SITUATA FINANCIARE (Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet)	*Burimet e Financimit 2026-2028* *Te ardhurat nga taksa dhe tarifat vendore: viti 2026 – 138,500 mije leke, 2027 – 140,000 mije leke, 2028 – 142,000 mije leke.* *Te ardhuara nga transferta e pakushtezuar: : viti 2026 – 304,124 mije leke, 2027 – 314,325 mije leke, 2028 – 325,834 mije leke.* *Transferta e pakushtezuar sektoriale: : viti 2026 – 166,644 mije leke, 2027 – 166,642 mije leke, 2028 – 166,6422 mije leke.* *Totali i te ardhurave: viti 2026 – 609,269 mije leke, 2027 – 620,969 mije leke, 2028 – 634,478 mije leke* *Plani i shpenzimeve:* *Shpenzime korrente: : viti 2026 – 501,815 mije leke,* *Shpenzime kapitale: viti 2026 – 107,453 mije leke* *Totali i shpenzimeve:* *viti 2026 – 609,269 mije leke*
DREJTORIA PËRGJEGJËSE	*Drejtoria e Planifikimit, Menaxhimit Financiar, dhe Sherbimit Social*
RAPORTIMI DHE MONITORIMI	*Bashkia do te beje raportimin sipas te gjithe kalendarit te procesit (legjislacionit) te raportimit te zbatimit te buxhetit.*
IMPAKTI SOCIAL DHE GRUPET QË PREKEN	*Ne PBA 2026-2028dhe buxhetin e vitit 2026, jane konsideruar dhe adresohen te gjitha ceshtjet sociale te komunitetit, vecanerisht per personat me aftesi te kufizuara, pensionistet, personat me semundje te renda etj.*
KONSULTIMI PUBLIK	*Konsultimet publike per PBA 2026-2028 dhe Buxhetin 2026 jane zhvilluar ne muajin Maj 2025 dhe Tetor-Nentor 2025 te cilat jane te regjistruara ne regjistrin*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
KESHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I EKONOMISE DHE ADMINISTRIMIT FINANCIAR

	elektronik te Keshillit Bashkiak ne web te Bashkise/Rubrika Keshilli

Komisioni i Përhershëm i Ekonomise dhe Administrimit Financiar i mbledhur më datën *23.12.2025* pasi shqyrtoi Projekt-vendimin për miratimin e Projekt Aktit, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Këshillit Bashkiak:
a. Kalimin e projekt aktit në mbledhjen e këshillit për vlerësim të mëtejshëm për vlerësim dhe miratim.
b. <u>Miratimin e projektaktit</u>
c. Refuzimin e miratimit të Projektaktit
d. Ti kerkoje drejtorise perkatese informacion shtese per projektvendimin
e. Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
   - Pika ..... e projektvendimit të ndryshojë në "_____"
   - Pika ..... e projektvendimit të ndryshojë në"_____"
   - Tabela ..... e projektvendimit të ndryhsojë në"_____"
   - Paragrafi ..... i projektvendimit të ndryshojë në "_____"

Bashkëlidhur argumentat e Vendimarrjes dhe mendimi i pakicës i parqitur në procesverbalin e Komisionit

Kryetari i Komisionit: Haxhi Çollaku

Nenkryetar i Komisionit: Fatmit Belba

Sekretari/e i/e Komisionit: Erdiola Leka (mungesë)

Prrenjas, më: 23. 12. 2025